



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 64, datë 12.06. 2020

PËR MIRATIMIN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR PRANË BASHKISË TIRANË

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika, nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe “d”, nenit 25, pikat 2 dhe 4, nenit 54, shkronja “ç” dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 113, të Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr. 540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave artistiko - kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar, udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko - kulturor”, Vendimit nr. 157, datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020–2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, vendimit nr.12, datë 11.03.2016 të Këshillit Bashkiak “Rregullore mbi financimin e projekteve kulturore, artistike, rinore dhe sportive”, memos me nr. 17066 prot, datë 28.05.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë përbërjen e këshillit artistiko - kulturor pranë Bashkisë Tiranë për periudhën 2020-2022, ku bëjnë pjesë: Robert Ndrenika; Yllka Mujo; Helidon Haliti; Diana Çuli; Luiza Gega; Lorik Cana; Dorian Koci; Meri Kumbe; Eraldo Rexho.
 2. Pagesa për çdo anëtar të këshillit artistiko - kulturor, të jetë sipas vlerës maksimale, të përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Vendimi nr. 72, datë 07.06.2018 i Këshillit Bashkiak “Për krijimin e këshillit artistiko - kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

K R Y E T A R

TONI GOGU